


ALBANIAN



Lambeth
**SANCTUARY
SERVICES**



Lambeth

Paketa e Mirëseardhjes për Kërkuesit e Strehimit



Ju mirëpresim në Lambeth

www.lambeth.gov.uk/lambeth-sanctuary-services

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	2
Këshilli i Lambeth	2
Shërbimet e Strehimit të Lambeth	3
Grupet vullnetare dhe komunitare vendore	3
Shëndeti dhe mirëqenia	3
Mbrojtja e sigurt	4
Policia dhe zjarrfikësit	4
Artikuj të nevojshëm	5
Edukimi	5
Seanca javore për familjet me fëmijë të vegjël	6
Aktivitete për të rinjtë	6
Bibliotekat	7
Informacion i rëndësishëm në lidhje me hedhjen e bishtave të cigareve dhe mbeturinave	7
Agjencia e këshillimit dhe këshilla juridike pa pagesë	8
Udhëtimi	8
Vendet e adhurimit	9
Parqet publike dhe hapësirat e gjelbra	9
Bankat për rroba dhe foshnjat	10
Dyqanet dhe tregjet lokale	10
Çfarë të bëni në Lambeth dhe përreth në Londër	11
ESOL	11

KËSHILLI I LAMBETH

- Ne duam të sigurohemi që të keni mbështetjen që ju nevojitet në Lambeth dhe të përfitoni nga ndihma dhe mundësitë e ofruara nga bashkia në të cilën jetoni. Kjo paketë ju jep informacion mbi shërbimet dhe institucionet në Lambeth për ju dhe familjen tuaj.
- Në rast se keni nevojë për ndihmë, ju mund të telefononi në numrin 020 7926 1000 ose mund të vizitoni faqen www.lambeth.gov.uk
- [Këtu është një link i hartës së Lambeth](#), me lagjet e identifikuara (zonat në të cilat është ndarë bashkia, secila me këshilltarin e zgjedhur të saj).

SHËRBIMET E STREHIMIT TË LAMBETH

- Shërbimet e Strehimit të Lambeth punojnë për të mbështetur dhe mirëpritur kërkuesit e strehimit (azilkërkuesit, refugjatët dhe persona të tjerë të prekur nga migracioni i detyruar).
- Në rast se dëshironi të kontaktoni me Shërbimet e Strehimit të Lambeth, ju lutemi dërgoni email në adresën: sanctuary@lambeth.gov.uk
- Ne gjithashtu mund t'ju vëmë në kontakt me organizatat bamirëse lokale të cilat mund t'ju ndihmojnë – shihni disa të tilla më poshtë.

GRUPET VULLNETARE DHE KOMUNITARE VENDORE



- **Migrant Help:** www.migranthehelpuk.org
- **Care4Calais:** www.care4calais.org
- **South London Refugee Association:** www.slr-a.org.uk
- **London LGBTQ+ Community Centre:** www.londonlgbtqcentre.org

SHËNDETI DHE MIRËQENIA



- Ju mund të regjistroheni tek një Mjek i Përgjithshëm ose dentist. Ju nuk keni nevojë të paraqisni provë për adresën, dokumentin e identifikimit ose statusin e imigracionit për t'u regjistruar.
- Personeli i hotelit ose Migrant Help (www.migranthehelpuk.org/Pages/Category/asylum) mund t'ju ndihmojnë gjithashtu të regjistroheni tek një Mjek i Përgjithshëm ose dentist.
- Ju mund të gjeni Mjekun e Përgjithshëm më të afërt këtu: www.nhs.uk/service-search/find-a-gp
- Ju mund të gjeni dentistin tuaj më të afërt këtu: www.nhs.uk/service-search/find-a-dentist

- Disa shërbime shëndetësore mund të jenë me pagesë dhe ju mund të merrni ndihmë për të mbuluar shpenzimet.
- Në rast urgjence, ju duhet të kontaktoni NHS duke telefonuar në numrin **111** ose duke vizituar faqen www.111.nhs.uk nëse mendoni se keni nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, por nuk jeni të sigurt se çfarë të bëni.
- Nëse është urgjente, telefononi në numrin **999** ose shkoni në spitalin tuaj më të afërt në njësinë e aksidenteve dhe urgjencave. Më shumë informacion mund të gjendet këtu: [Find Urgent Care services - NHS \(www.nhs.uk\)](http://www.nhs.uk)
- Telefonatat në numrin 111 dhe 999 janë pa pagesë.
- Ju mund të flisni me Mjekun tuaj të Përgjithshëm për çdo problem ose shqetësim në lidhje me shëndetin tuaj mendor. Ka disa organizata bamirëse dhe grupe në Lambeth dhe në internet që mund t'ju ndihmojnë, vizitoni: www.hubofhope.co.uk




MBROJTJA E SIGURT

- Në rast se keni ndonjë shqetësim në lidhje me mbrojtjen - për shembull, jeni të shqetësuar për mirëqenien tuaj fizike ose mendore ose të një personi tjetër që jeton në hotel - ju lutemi kontaktoni menaxherin e hotelit ose personelin tjetër të hotelit të cilët do t'ju ndihmojë të merrni mbështetjen e duhur.
- Në rast se jeni të shqetësuar për dhunën në familje kundër jush ose dikujt që njihni dhe jeni gati të kërkon ndihmë, kontaktoni **Gaia**:
 - Telefon: 020 7733 8724
 - Nga ora 08:00 deri në orën 18:00 çdo ditë, me një shërbim shtesë të thirrjes në pritje jashtë orarit të punës nëpërmjet të njëjtit numër kontakti.
 - Email: lambethvawg@refuge.org.uk

POLICIA DHE ZJARRFIKËSIT

- Policia mund t'ju ndihmojë në raste urgjente të tilla si dhuna, grabitja ose kur dikush ka kryer një krim. Ka dy numra pa pagesë për të kontaktuar policinë:



o **999** - Përdoret në rastet realisht urgjente, kur policia duhet të vijë me urgjencë. Për shembull, sulm i rëndë, përdhunim ose kur ka rrezik për jetën.

o **101** - Për raste të cilat nuk janë urgjente dhe për të raportuar krime që nuk kanë nevojë për një reagim të menjëhershëm të policisë. Për shembull, dëmtimi i pronës tuaj ose dyshimi për shpërndarjen e drogës në zonën tuaj.

101 është gjithashtu numri për të kontaktuar stacionin e policisë në zonën tuaj.

- Telefononi në numrin **999** në rast se në shtëpinë tuaj ka zjarr ose shihni zjarr diku tjetër.

ARTIKUJ TË NEVOJSHËM

- Këshilli dhe organizata të tjera bamirëse në zonë organizojnë herë pas here dhurime të artikujve të nevojshëm si për shembull pallto, atlete dhe laptopë.
- Hoteli juaj do t'ju ofrojë artikuj tualeti. Ju lutemi flisni me personelin e hotelit nëse keni nevojë për ndonjë nga sa vijon: xhel dushi, shampo, furçë dhëmbësh, pastë dhëmbësh, deodorant, brisqe, pluhur larës, produkte sanitare dhe peceta higjienike për gratë pas lindjes.
- Për gratë shtatzëna ose nënat që ushqejnë me gji, ju lutem flisni me personelin e hotelit i cili do t'ju ndihmojë me: një krevat portativ për fëmijë, një dyshek dhe mbështetëse përfshirë çarçafë dhe batanije për fëmijë (derisa t'ju sigurojnë një krevat fëmijësh), një govatë për fëmijë, një karrige të lartë për foshnjat mbi gjashtë muaj, pelena (në përmasat e duhura) dhe qese për pelenat.



• Ushqimi, shishet, pajisjet e sterilizimit dhe formula e qumështit pluhur do të sigurohen, nëse është e nevojshme, një herë në javë dhe në momentin e mbërritjes për foshnjat nën një vjeç. Ju gjithashtu mund të përdorni një çajnik ose një aneks kuzhine për ta përgatitur atë.

• Ju lutemi njoftoni personelin e hotelit në rast se keni nevojë për ushqim në kavanoz për fëmijët. Personeli i hotelit do t'ju ofrojë gjithashtu mundësinë për përdorimin e ushqimeve të përshtatshme për të futur ushqimet e forta.

Regjistrimi i fëmijës tuaj në shkollë ose në kolegji

- Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë që janë në moshë shkollore do të duhet të aplikojnë për një vend në shkollë/kolegj sa më shpejt të jetë e mundur. Informacione të hollësishme për të gjitha [shkollat fillore në Lambeth mund të gjenden këtu](#), dhe [për shkollat e mesme këtu](#).
- Ekzistojnë dy mënyra për të plotësuar formularët e aplikimit për shkollë/kolegj: në internet ose dërgimi i versionit të letrës së skanuar. Ju lutemi kontaktoni menaxherin e hotelit ose personelin tjetër të hotelit për t'ju ndihmuar të krijoni dhe dorëzoni aplikimin e shkollës.
- Brenda 15 ditëve nga dërgimi i aplikimit për shkollën/kolegjin, ekipi i Regjistrimit në Këshillin e Lambeth do t'u bëjë të ditur prindërve/kujdestarëve se cilën shkollë/kolegj do të ndjekë fëmija i tyre dhe cila do të jetë data e fillimit.



Mbështetje me blerjen e uniformave dhe mjeteve shkollore



- Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë që kërkojnë azil dhe që ndjekin shkollën kanë të drejtë të përfitojnë 100 £ secili për uniformë dhe sende të tjera të nevojshme shkollore. Shkollat do t'ia japin direkt këtë shumë fëmijës dhe Këshilli i Lambeth do të rimbursojë shkollën.
- Pyesni shkollën tuaj për këtë. Nëse ata kanë nevojë për më shumë informacion, kërkojuni atyre të dërgojnë email në adresën sanctuary@lambeth.gov.uk

Vakte pa pagesë në shkollë

- Aktualisht, fëmijët dhe të rinjtë që kërkojnë azil ose nuk kanë akses në fondet publike (FKPF) mund të marrin vakte pa pagesë në shkollë. Shkolla do të kujdeset për këtë duke kërkuar një kopje të dokumentit në bazë të Seksionit 95 nga Zyra e Brendshme si provë.
 - Në rast se keni ndonjë vështirësi për të marrë vakte pa pagesë në shkollë për fëmijën tuaj, ju lutemi dërgoni email në adresën sanctuary@lambeth.gov.uk për ndihmë.
- Që nga Shtatori i vitit 2023, të gjithë fëmijët që ndjekin shkollën fillore në Londër do të kenë të drejtën për vakte pa pagesë në shkollë, pa qenë nevoja për paraqitjen e dokumenteve.

SEANCA JAVORE PËR FAMILJET ME FËMIJË TË VEGJËL

- Ka seanca javore për familjet me fëmijë nën moshën pesë vjeç në tre vende, secila pranë një prej hoteleve. Shihni detajet më poshtë.

- **Agnes Riley Gardens, Clarence Avenue (cepi i rrugës Poynders Road), London, SW4 8NZ** – çdo të Mërkurë në periudhën nga ora 11:00 – 14:00
- **St. Stephen’s Children’s Centre, 1 Meadow Place, London, SW8 1XZ** – çdo të Martë në periudhën nga ora 13:00 – 15:00. Ekziston gjithashtu mundësia për të gatuar dhe ndarë vaktet gjatë këtyre seancave.
- **Sunnyhill Children’s Centre, Harborough Road, London, SW16 2XW** – çdo të Enjte në periudhën nga ora 11:00 – 14:00. Ekziston gjithashtu mundësia për të gatuar dhe ndarë vaktet gjatë këtyre seancave.

AKTIVITETE PËR TË RINJTË

- Gjatë pushimeve shkollore ka programe të ndryshme të Aktiviteteve dhe Ushqimit gjatë Pushimeve (HAF). Këto aktivitete janë pa pagesë dhe variojnë nga sporti deri tek arti dhe zanatet.
- Këshilltarët për të Rinjtë do të vizitojnë hotelin një herë në muaj për të dhënë informacion rreth këtyre aktiviteteve, për të ndihmuar të rinjtë të regjistrohen dhe ndonjëherë ata do të jenë në gjendje t'i shoqërojnë të rinjtë në këto aktivitete në ditën e parë të programit.



- Për të mësuar më shumë rreth këtyre aktiviteteve dhe për të regjistruar fëmijën tuaj, vizitoni faqen: www.lambeth.gov.uk/children-young-people-and-families/Young-peoples-support/activities-young-people
- Për të parë gjëra të tjera argëtuese për të rinjtë në Lambeth, të tilla si klubet e të rinjve, parqet, këndet e lojërave dhe mjediset e kohës së lirë, [hidhni një sy kësaj harte interaktive](#).

BIBLIOTEKAT

- Të gjitha bibliotekat publike drejtohen nga këshilli dhe ata ofrojnë kompjuterë dhe përdorimin e internetit. Mund të rezervoni maksimumi dy orë në ditë dhe përdorimi i tij është pa pagesë.
- Për të gjetur një bibliotekë pranë jush, ju lutemi kontrolloni [këtë link](#).
- Ju mund të merrni një kartë të bibliotekës Lambeth ose duke ia kërkuar personelit të Receptonit në një bibliotekë të Lambeth ose duke vizituar këtë faqe interneti që përmban formularët e aplikimit për kartën e bibliotekës në gjuhë të ndryshme: www.lambeth.gov.uk/libraries-and-archives/join-library-0/library-membership-application-forms-other-languages

- Si anëtar i Bibliotekës së Lambeth, ju mund të merrni hua deri në 20 artikuj ose libra, duke përfshirë deri në gjashtë artikuj audiovizualë (DVD, lexim i regjistruar i një libri dhe kurse të gjuhës).

INFORMACION I RËNDËSISHËM NË LIDHJE ME HEDHJEN E BISHTAVE TË CIGAREVE DHE MBETURINAVE

- **E rëndësishme:** Në hapësirat publike, **mos:**
 - Hidhni mbeturina, duke përfshirë bishtat e cigareve dhe çamçakëz
 - Pështyni në një hapësirë të hapur publike
 - Urinoni në publik
- Nëse e bëni këtë, ju mund të gjobiteni me 150 £, e cila duhet të paguhet brenda 14 ditëve nga data e lëshimit të Njoftimit të Gjobës Fikse (FPN). Në rast se gjoba nuk paguhet, kjo mund të ndikojë në kërkesën tuaj për azil nëse nuk paguhet. [Klikoni këtu për më shumë informacion në lidhje me këtë.](#)
- Ju duhet t'i hidhni mbetjet në koshin publik më të afërt të mbeturinave dhe bishtave të cigareve duke përdorur tavllat e koshave publike ose tavllat portative.



AGJENCIA E KËSHILLIMIT DHE KËSHILLA JURIDIKE PA PAGESË

Këshillimi i Qytetarëve

- Citizens Advice është një organizatë e pavarur e specializuar në ofrimin e informacionit dhe këshillimit konfidencial për të ndihmuar njerëzit me probleme ligjore, borxhi, konsumatore, strehimi dhe probleme të tjera në Mbretërinë e Bashkuar.
- Citizens Advice është një organizatë bamirëse kombëtare dhe një rrjet i organizatave bamirëse vendore e cila ofron këshilla konfidenciale pa pagesë në internet, nëpërmjet telefonit dhe personalisht.



- Faqja e internetit: www.citizensadvice.org.uk
- Telefon: 0808 223 1133
- Citizens Advice ofron gjithashtu shërbimin Help to Claim [Ndihmë për të Kërkuar] i cili mund t'ju ndihmojë në fazat e hershme të aplikimit për Kreditin Universal. Ju mund të bisedoni me ta në telefon, ose në internet nëpërmjet chat-it.
 - Për më shumë informacion, vizitoni faqen: www.citizensadvice.org.uk/helptoclaim ose telefononi në numrin 0800 144 8444.

Law Works [Ligji Funksionon]

- Law Works [Ligji Funksionon] është një organizatë bamirëse që ushtron aktivitetin në Angli dhe Uells e cila lidh avokatët vullnetarë me njerëz që kanë nevojë për këshilla juridike, të cilët nuk kanë të drejtë për ndihmë juridike dhe nuk kanë mundësi të paguajnë.
 - Faqja e internetit: www.lawworks.org.uk
 - Adresa: 296-302 High Holborn, London WC1V 7JH

UDHËTIMI

Udhëtimi rreth Lambeth dhe Londër

- Lambeth është i lidhur mirë me metro, autobus dhe me tren me pjesën tjetër të qytetit.
- Kur udhëtoni me metro ose tren, ju duhet të kaloni kartën tuaj Oyster ose kartën pa kontakt kur hyni në stacion **dhe** kur dilni nga stacioni i fundit.
- Kur merrni autobusin në Londër, ju duhet ta kaloni kartën tuaj Oyster ose kartën e pagesës pa kontakt vetëm **një herë** kur hipni në autobus. Ju nuk keni nevojë ta kaloni atë kur zbrisni nga autobusi.

Kartat Oyster

- Karta Oyster është një metodë pagese për transportin publik në Londër. Të rinjtë e moshës 11 deri në 17 vjeç dhe personat mbi 60 vjeç që jetojnë në Londër kanë të drejtë të kenë Karta Oyster me Fotografi të cilat u japin atyre mundësinë për udhëtime të reduktuara ose pa pagesë në Londër.
- Në hotele do të ofrohet mbështetje personale në baza mujore nga vullnetarë të autorizuar nga Këshilli Lambeth për të aplikuar për këto karta Oyster me Fotografi. Këshilli i Lambeth do të paguajë një tarifë prej 15 £/20£ për Kartën Oyster me Fotografi.
- Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni faqet përkatëse të Transportit për Londrën (Tfl) :
 - [11 – 15 Zip Oyster Photocard \[mosha 11 - 15 Kartë Zip Oyster me Fotografi\]](#)
 - [16+ Zip Oyster Photocard \[mosha 16+ Kartë Zip Oyster me Fotografi\]](#)
 - [60+ London Oyster Photocard \[mosha 60+ Kartë Oyster me Fotografi për Londrën\]](#)



VENDET E ADHURIMIT

- Lambeth është plot me vende të sigurta ku mund të adhuroni dhe praktikoni fenë tuaj. Këto mund të gjenden lehtësisht duke kërkuar në internet për vendin tuaj fetar të adhurimit në zonën tuaj lokale.

PARQET PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E GJELBRA

- Për të parë se ku ndodhen parqet dhe hapësirat e gjelbra në Lambeth, vizitoni faqen: www.lambeth.gov.uk/parks
- Këtu ndodhen disa parqe në Lambeth dhe përreth tij:
 - Brockwell Park, Norwood Road, Herne Hill, SE24 9BJ
 - Clapham Common, Windmill Dr, London SW4 9DE
 - Streatham Common, London, SW16 3BX
 - Tooting Commons, London, SW16 1RT
 - Dulwich Park, College Rd, London, SE21 7EB
- Për disa rrugë të shkëlqyera ku mund të ecni në **Lambeth** vizitoni: www.alltrails.com/en-gb/england/london/lambeth/walking
- Për më shumë rrugë ecjeje në **Londër**, vizitoni: www.alltrails.com/en-gb/england/london/walking
- Nëse ju pëlqen vrapimi, ka një Aktivitet Vrapimi çdo të Shtunë në parqet përreth Lambeth dhe Londrës. Vizitoni: www.parkrun.org.uk për të zbuluar se ku dhe kur zhvillohen ato. Këtu mund të gjeni linkun e faqeve të Brockwell Park dhe Clapham Common Park Run:
 - www.parkrun.org.uk/brockwell
 - www.parkrun.org.uk/claphamcommon



BANKAT PËR RROBA DHE PËR FOSHNJAT

- **Banka e rrobave për të rritur** në adresën St Vincent's Centre Brixton, Talma Road, London, SW2 1AS
 - Çdo të Martë të fundit të muajit, nga ora 11:00 deri në 14:00.
- **Banka e foshnjave** në adresën Mosaic Clubhouse, 65 Effra Road, London, SW2 1BZ
 - Çdo të Shtunë të fundit të muajit, nga ora 12:00 deri në 13:00.

DYQANET DHE TREGJET LOKALE

- Supermarketet më të njohura në Mbretërinë e Bashkuar janë Sainsbury's, Asda, Morrisons, Aldi, Iceland, dhe Lidl. Vizitoni www.supermarketgo.co.uk për të gjetur supermarketin tuaj më të afërt.



- Në Lambeth ka shumë dyqane dhe tregje të mrekullueshme që shesin një shumëllojshmëri ushqimesh. Tregjet kanë çmime të mira dhe ofrojnë një gamë të gjerë ushqimesh ndërkombëtare.
 - **Brixton Market**, Brixton Station Rd, London, SW9 8PD
 - Gjatë ditëve të javës ka tezga me ushqime në rrugë dhe një treg të përgjithshëm, të Shtunave ka tezga të ndryshme dhe çdo të Diel ka një Treg të Fermerëve Brixton që shet produkte organike dhe të rritura në kushtet natyrore.
 - **Lower Marsh Market**, Lower Marsh, London, SE1 7RG
 - Ky treg i lulëzuar i drejtuar nga "We Are Waterloo". Ai funksionon nga e Hëna deri të Shtunën.
 - **Venn Street Market**, Venn St, London, SW4 0AT
 - Ky treg i gjallë ushqimor në zemër të Clapham është i hapur ditëve të Shtuna.
 - **Herne Hill Market**, Railton Rd, London, SE24 0JN
 - Ky treg i gjallë është plot me tezga që shesin ushqime lokale, si dhe punime arti dhe me dorë dhe është i hapur të Dielave nga ora 10:00 deri në orën 16:00.
 - **Vauxhall Market**, Battersea Park Rd, Nine Elms, London, SW8 5DZ
 - Ai është i hapur të Dielën, nga ora 07:00 – 14:00.

ÇFARË TË BËNI NË LAMBETH DHE PRANË NË LONDËR



Lambeth dhe Londra kanë shumë gjëra emocionuese për të bërë dhe vende për të eksploruar.

- **Muzetë dhe galeritë e artit pa pagesë:** Shumë muze dhe galeri arti në Londër janë pa pagesë, shikoni këtë faqe në internet për më shumë informacion: www.timeout.com/london/museums/free-art-galleries-museums-in-london
- **Vauxhall City Farm**, 165 Tyers Street, London, SE11 5HS – një fermë pa pagesë në qytet, për më shumë informacion, vizitoni faqen: www.vauxhallcityfarm.org

Londra ka shumë atraksione historike dhe kulturore. Mund t'ju duhet të paguani për të hyrë në disa prej tyre, por mund t'i shijoni edhe pa hyrë brenda. Këtu janë disa shembuj:

- **The London Eye [Syri i Londrës]**, Riverside Building, County Hall, London, SE1 7PB
- **Houses of Parliament and Big Ben [Ndërtesa e Parlamentit dhe Big Ben]**, Westminster Bridge, London, SW1A 0AA
- **Westminster Abbey [Abacia e Westminster-it]**, 20 Deans Yd, London SW1P 3PA
- **Buckingham Palace [Pallati i Bakingamit]**, London, SW1A 1AA
- **St Paul's Cathedral [Katedralja e Shën Palit]**, St. Paul's Churchyard, London, EC4M 8AD

- **Trafalgar Square [Sheshi Trafalgar]**, London, WC2N 5DN

ESOL

- Në Lambeth ka shumë kurse ESOL pa pagesë (Anglisht për Folësit e Gjuhëve të Tjera), të cilat ofrohen nga Lambeth Adult Education [Edukimi për të Rriturit në Lambeth], bibliotekat, kolegjet dhe grupet e komunitetit. Ofrohen kurse dhe klasa bisede për fillestarët e plotë nga Niveli Hyrës 1 deri në Nivelin 2.
- **Në faqet në vijim** jepen harta e klasave ESOL në Lambeth dhe në afërsi të tij, me një tabelë shoqëruese me më shumë detaje që korrespondon me numrat në hartë. Ju do të jeni në gjendje të shihni kurset formale dhe joformale ESOL.
- Care4Calais organizon kurse joformale të Anglishtes për banorët e hoteleve në Vauxhall, të cilat udhëhiqen nga Frances Plowden. Flisni me personelin e Care4Calais në Vauxhall për më shumë informacion.



Harta e ESOL në dhe pranë Lambeth




Tabela e detajuar mbi ESOL

Numri në hartë	Ofruesi	Orët	Kontakt	Adresa	Lloji i ofrimit	Informacion tjetër
1	Mësimi për të Rritur Lambeth në Kolegjin Morley, Waterloo	E Shtunë nga ora 10:00-13:00 ose nga ora 13:30-16:30 E Martë dhe e Mërkurë nga ora 10:30-13:00	07395336234 ose Luna.Vythalingum@morleycollege.ac.uk	Waterloo Centre, 61 Westminster Bridge Rd London SE1 7HT	Kurse ESOL të pa-akredituara dhe formale - kurse të Akredituara të Nivelit Hyrës 1 të Shtunave. ESOL i paakredituar për lexuesit dhe shkrimtarët e rinj të Martën/Mërkurë në mëngjes	Kurset zhvillohen vetëm gjatë periudhës akademike në Qendrën Waterloo (çerdhe për një numër të kufizuar fëmijësh mbi 15 muajsh)
2	Anglisht për Veprim	TBC		Henry Fawcett Children's Centre, Clayton Street. Kennington, SE11 5BZ	Joformal, Klubi i Bisedave ESOL	
3	Bibliotekat Lambeth, Biblioteka South Lambeth	E Shtunë, 10:30 - 12:30	southlambethlibrary@lambeth.gov.uk	180 South Lambeth Road, London, SW8 1QP	Formal - ESOL në Internet me Lino - Bisedë	
4	Mësimi për të Rriturit Lambeth në Kolegjin Morley College, Liz Atkinson Children's Centre	Të Enjten në mëngjes	07396 397 487 ose community@morleycollege.ac.uk ose lizatkinsoncc@jsfederation.org.uk	Liz Atkinson Children's Centre, 9 Mostyn Road, SW9 6PH	Jo-formal - ESOL i paakredituar në nivelin hyrës	Kursi zhvillohet vetëm gjatë periudhës akademike. Çerdhe për një numër të kufizuar fëmijësh në moshën mbi 6 muaj
5	Qendra Komunitare e Springfield	E Hënë - E Enjte, ora 10:00 -12:00	Elisabeth Ruiz	Christchurch Hall, 41 Union Grove SW8 2QG	Jo-formale	
6	Mësimi për të Rritur Lambeth në Kolegjin Morley College, Stockwell	Disa kurse gjatë ditës së javës dhe një klasë e madhe ditën e Shtunë, 10:00 - 13:00 ose 13:30 - 16:30.	07395336234 ose Luna.Vythalingum@morleycollege.ac.uk	Stockwell Centre, 1 Studley Rd, London SW4 6RA	Kurse Formale - të Akredituara ESOL Niveli Hyrës 1 dhe Niveli Hyrës 2, kurse të Paakredituara dhe Formale - kurse të Akredituara ESOL Niveli Hyrës 1 deri në Nivelin 1	Qendra Stockwell (prapa stacionit të metrosë Stockwell) nuk ka çerdhe.
7	Katherine Lowe Settlement (KLS)	E Enjte, 12:30 - 14:30		108 Battersea High St, London SW11 3HP	Jo-formale	Tarifat e paguara

Numri në hartë	Ofruesi	Orët	Kontakt	Adresa	Lloji i ofrimit	Informacion tjetër
8	ESOL - Qendra Baytree	E Hënë - e Enjte (orari i ndryshueshëm)	Margaret Browne, 07 432 738360, margaret@baytreecentre.org.uk	300 Brixton Road, London, SW9 6AE	Formale - Kurse ESOL për shkrim dhe lexim për gratë, Joformale - Klubi i Bisedave ESOL për vajzat që presin një vend në shkollë	Programi i lëvizshmërisë sociale, seanca për mirëqenien, aktivitete ekstra-kurrikulare dhe pushimi për vajzat, pa çerdhe
9	Anglisht për TË GJITHË! Organizata Indo-Amerikane për Refugjatët dhe Migrantët (IRMO)	Në internet	0207 733 9977 ose ete.info@irmo.org.uk		Jo-formale	ESOL Kurse kompjuteri dhe seminare të teknologjisë së informacionit për lundrimin në internet, përdorimin e sigurt të internetit, menaxhimin e financave në internet, gjetjen e një pune dhe aksesin në shërbimet në internet.
10	Mësimi për të Rriturit në Lambeth në MI Skills & Development	Nga e Hëna në të Premte (në varësi të kursit), 09:30-12:00, 12:00-15:00 dhe 15:30-18:00.	020 7501 6450 ose info@micosolutions.co.uk	The Queen, 47a Bellefields Road, Brixton. SW9 9UH	Formale - Lexim dhe Shkrim ESOL në E1, E2, E3, Niveli 1 dhe Niveli 2	Nuk ka çerdhe, Të papunë por mund të pranohen edhe disa të punësuar.
11	Alison Newbery	Të Enjten pasdite		91 Clapham High St, London SW4 7DB	Jo-formale	Nuk ka çerdhe
12	Bibliotekat Lambeth, Biblioteka Clapham	E Martë, 14:00 - 16:00	anewbery52@gmail.com	Mary Seacole Centre, 91 Clapham High Street. London, SW4 7DB	Joformal, Klubi i Bisedave ESOL	Nuk ka çerdhe

Numri në hartë	Ofruesi	Orët	Kontakt	Adresa	Lloji i ofrimit	Informacion tjetër
13	Kolegji Lambeth, Clapham	Nga e Hëna deri të Premten, gjatë ditës	customerse rvices@southbankcollege.ac.uk	45 Clapham Common South Side, London SW4 9BL	Formal -16-18. Niveli i Para Hyrjes L1	
14	Kolegji Lambeth, Clapham	Ditëve të javës, ditës, varësisht nga kursi	customerse rvices@southbankcollege.ac.uk	45 Clapham Common South Side, London SW4 9BL	Formal-para hyrjes Në I1.	14-16 për aplikantët që nuk janë në shkollë, rekrutim gjatë gjithë vitit në Clapham, Ditët e javës, gjatë ditës, në varësi të kursit.
15	Kolegji Lambeth, Brixton	Pasdite gjatë javës, vetëm Niveli Hyrës	customerse rvices@southbankcollege.ac.uk	56 Brixton Hill, London SW2 1QS	Formale	Kurse të bazuara në kompjuter ESOL
16	Kolegji Lambeth, Brixton	Ditët e javës gjatë ditës Ditët e javës në mbrëmje Të shtunat gjatë ditës	customerse rvices@southbankcollege.ac.uk	57 Brixton Hill, London SW2 1QS	Aftësim Formal për të Rriturit, Hyrja 1, L1 dhe L2	Aftësitë funksionale në matematikë si pjesë e kurseve ESOL dhe kurse të pavarura. Sigurimi i mjeteve të testimit, regjistrim i detyrueshëm, pa çerdhe.
17	Care4Calais	Të Mërkurën në mëngjes	Ascension Church, Balham	23 Malwood Rd, London SW12 8EN	Jo-formale	
18	Mësimi i Pakufizuar	4 herë në javë	https://forms.gle/GDHKWh5NWxTo1cW36	Agnes Riley Centre, Atkins Rd SW12 0AH	Klubet Joformale të Bisedimit ESOL gjatë sesioneve të studimit familjar	ESOL - në internet dhe ballë për ballë (Southwark dhe Lambeth)
19	Vizioni i Ri për Gratë	Të Hënën në mëngjes	nighat.khan@newvision4women.co.uk	Agnes Riley Centre, Atkins Rd SW12 0AH	Jo-formale	Vetëm gratë
20	Lambeth Të Mësuarit E	Niveli Hyrës 1 (Fillestar) - e Mërkurë dhe e Enjte,	hello@ripelarning.com	Rosendale Community Centre,	Formal, Hyrja në L3,	I kombinuar në internet dhe personalisht

Numri në hartë	Ofruesi	Orët	Kontakt	Adresa	Lloji i ofrimit	Informacion tjetër
	Të Rriturve Në Të Mësuarit E Pjekur	ora 10:00-12:00. Niveli Hyrës 2 (Fillestar) - e Hënë dhe e Martë, ora 10:00-12:00. Niveli Hyrës 3 (Para-Mesatar) - e Enjte dhe e Premte, ora 13:00-15:00. Niveli 1 (Mesatar) - e Mërkurë, ora 16:00 - 18:00. Niveli Para-Hyrës (Fillestar Absolut) - e Premte, ora 10:00-12:00		London, SE24 9DR		
21	Bibliotekat Lambeth, Biblioteka Balham	E hënë, 10:00-12:00			Jo-formale	
22	SLRA (slr-a.org.uk) Woodlawn s Centre	E Martë, 10:30 - 12:00 dhe e Enjte, 13:15 - 14:45	0203 490 3443 ose admin@slr-a.org.uk	16 Leigham Court Rd SW16 2PJ	Jo-formale	
23	Bibliotekat Lambeth, Biblioteka West Norwood	E Hënë, ora 18:00 - 20:00	westnorwoodlibrary@lambeth.gov.uk	1-5 Norwood High Street. London, SE27 9JX	Formale	
24	Bibliotekat Lambeth, Biblioteka Streatham	E Hënë, 09:30 - 14:00 dhe e Mërkurë, 10:00 - 14:00	streathamlibrary@lambeth.gov.uk	63 Streatham High Road, London. SW16 1PN	Formale	
25	CARAS	ESOL për gratë të Mërkurën në mëngjes, sesione kompjuterike fillestare për Gratë të Premten në mëngjes	020 8767 5378	25 Blakenham Rd, London SW17 8NE	Bisedë joformale, ESOL	Vetëm për gratë, çerdhe për fëmijët në dispozicion, tarifat e paguara
26	Mësimi për të Rriturit Lambeth në Kolegjin Morley College.	Ditët e javës	073953362 34 ose Luna.Vythalingum@morleycollege.ac.uk	Lewington Centre, 9 Eugenia Road, SE16 2RU	ESOL i paakredituar për lexuesit dhe shkrimtarët e rinj të Martën/Mërkurën në mëngjes	Kurset zhvillohen vetëm gjatë semestrit në Qendrën Lewington (pa çerdhe)

Numri në hartë	Ofruesi	Orët	Kontakt	Adresa	Lloji i ofrimit	Informacion tjetër
	Lewington Centre					
27	Mësimi për të Rriturit Lambeth në Kolegjin Morley College, Jubilee Children's Centre	Të Hënën në mëngjes	07395 397 487 or community@morleycollege.ac.uk or lizatkinsonc@jsfederation.org.uk	Jubilee Children's Centre, Tulse Hill, SW2 2JE	ESOL jo-formal, i paakredituar për lexuesit dhe shkrimtarët e rinj të Martën/Mërkurën në mëngjes	Kurset zhvillohen vetëm gjatë semestrit në Qendrën Lewington (pa çerdhe)
N / A	Lambeth Adult Learning në Thames Reach	Në internet		Në internet	Në internet	